

The background of the cover is a photograph of the AMF building, a modern multi-story structure with a light-colored facade and numerous windows. A red flag is flying from a pole in front of the building. In the foreground, there is a small tree and a paved area.

# Periodik mujor Nr. 199 Dhjetor 2025

Në  
këtë  
periodik  
do të lexoni:

Znj. Adela Xhemali merr mandatin si anëtare  
e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare  
që do të mbajë funksionin e  
Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv



## VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,  
Janar-Nëntor 2025

5

## ZHVILLIME TË TJERA

6-8

## BOTIME PROFESIONALE

9-14

## INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

15-17

**Znj. Adela Xhemali merr mandatin si  
anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,  
që do të mbajë funksionin  
e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv**



Tiranë, 5 dhjetor 2025 – prezantohet në AMF Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive

Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 102/2025, datë 4 dhjetor 2025, miratoi emërimin e Znj. Adela Xhemali në detyrën e anëtares së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), e cila do të ushtrojë funksionin e Drejtoreshës së Përgjithshme Ekzekutive.

Në ambientet e AMF-së u zhvillua ceremonia zyrtare e prezantimit të saj, ku morën pjesë Kryetarja e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, Znj. Milva Ekonomi, anëtarët e Bordit Drejtues, drejtues të institucionit, si dhe Drejtoresha në përfundim të mandatit, Znj. Mimoza Kaçi.

Në fjalën e saj, Znj. Ekonomi theksoi rëndësinë e drejtimit të suksesshëm të Autoritetit, veçanërisht në kushtet e sfidave që shoqërojnë procesin e integritit evropian. Ajo nënvizoi rolin thelbësor të mbikëqyrjes së tregut financiar jobankar në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe domosdoshmërinë për forcimin e standardeve të transparencës dhe besueshmërisë institucionale.

Vijon ...

**Znj. Adela Xhemali merr mandatin si  
anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,  
që do të mbajë funksionin  
e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv**

... Vijon

Drejtoresha e sapoemëruar, Znj. Adela Xhemali, në fjalën e saj, shprehu falënderimet për Kuvendin e Shqipërisë për besimin e dhënë, dhe nënvizoi se integriteti dhe përgjegjshmëria do të jenë busulla e punës së Autoritetit.

“Prioritetet e së ardhmes do të fokusohen në avancimin e procesit të integritetit evropian, zhvillimin teknologjik dhe inovacionin, forcimin e transparencës dhe standardeve të mbikëqyrjes dhe të mbrojtjes së konsumatorit. Kombinimi i përvojës së konsoliduar me energjinë dhe dinamizmin e brezit të ri do të forcojë më tej kapacitetet dhe rolin e institucionit”, u shpreh Znj. Xhemali.

Institucioni i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të garantojë stabilitet financiar, transparencë dhe rritje të besimit në tregjet financiare jobankare, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – nëntor 2025

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar – nëntor 2025 kapën vlerën 24,254 milionë lekë, ose 10.17% më shumë se në janar – nëntor 2024. Gjatë periudhës janar – nëntor 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,506,529 me një rritje prej 4.69% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.54% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.43% dhe risigurimi me 0.028%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.58% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.42% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – nëntor 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 7,488 milionë lekë, ose 3.61% më pak se në janar – nëntor 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar – nëntor 2025 kapën vlerën 5,716 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 0.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar – nëntor 2025 arritën rreth 15,139 milionë lekë, ose 12.40% më shumë se në janar – nëntor 2024.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar – nëntor 2025 (Në %)



# ZHVILLIME TË TJERA

## Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare krijon grupin e trajnerëve për të rritur edukimin financiar në tregun e sigurimeve.



Tiranë, 9 Dhjetor 2025 – Workshop për trajnimin e trajnerëve në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi workshop-in për Trajnimin e Trajnerëve në tregun e sigurimeve. Ky workshop është pjesë e projektit që synon rritjen e edukimit financiar të publikut dhe mbështetet nga Zyra e Asistencës Teknike (OTA) të Departamentit Amerikan të Thesarit të Shtetit.

Gjatë ditëve të workshop-it trajnuesja Znj. Danielle Hopkins prezantoi koncepte teorike dhe mënyra praktike për të përcjellë informacionin lidhur me tregun e sigurimeve. Vëmendje në trajnim ju kushtua përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit me publikun dhe përshtatja e tyre për grupet e synuara, sidomos rinisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, SME.



Vëmendje në trajnim ju kushtua përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit me publikun dhe përshtatja e tyre për grupe të ndryshme të synuara, sidomos rinisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, SME.

## Autoritet i Mbikëqyrjes Financiare krijon grupin e trajnerëve për të rritur edukimin financiar në tregun e sigurimeve.



... vijon

Pjesëmarrës ishin mbi 30 përfaqësues të shoqërive të sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës, shoqatat e sigurimeve, bankat broker, si edhe pedagogë të universiteteve publike dhe private.

Workshop-i ishte organizuar në mënyrë interaktive dhe u punua me grupe të vogla për të diskutuar dhe dhënë ide se cilat mund të jenë mënyrat më efektive të komunikimit për të përcjellë edukimin në sigurime për publikun si edhe ndërtimin e një plani veprimi në të ardhmen.

Ky aktivitet është në vijim të aktiviteteve të zhvilluara që gjatë vitit 2024 për edukimin financiar në sigurime, dhe do të vijojë edhe gjatë vitit 2026 me një plan të detajuar të aktiviteteve njohëse në tregun e sigurimeve.



## Publikohet për Konsultim Publik Projektligji “Për Tregjet e Kripto-Aseteve”

The screenshot shows the official website of the Ministry of Economy and Innovation. At the top, there is a navigation bar with the logo of the Ministry and the text 'Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike'. On the right, there are icons for 'Qytetarët', 'Ekspertët', 'Institucionet', 'Sondazhe', and 'Raporte'. The main content area features a search bar and a section titled 'PROJEKTILIGJI "PËR TREGJET E KRIPTO-ASETEVE"'. Below the title, it indicates the Ministry of Economy and Innovation, the date of publication (27.11.2025), and the date of the consultation (29.12.2025). There are options to download the document in PDF or XML format. The main text of the project law is visible, starting with 'Qëllimi i projektligjit "Për Tregjet e Kripto-Aseteve" është vendosja e një kuadri gjithëpërfshirës ligjor për ushtrimin e veprimtarive të emetimit të krypto-aseteve dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me to, si dhe përfshirjen e plotë me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e financave digjitale, duke përfshirur kështu detyrimet e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.' On the right side of the page, there is a contact information box for the Ministry of Economy and Innovation, including the address, phone number, and website.

Projektligji “Për Tregjet e Kripto-Aseteve” është publikuar për konsultim publik nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Dokumenti i plotë është i disponueshëm në platformën zyrtare të konsultimeve publike, në likun:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/899>

Projektligji synon të vendosë një kuadër ligjor për emetimin dhe shërbimet e krypto-aseteve në Shqipëri, në përputhje me Rregulloren (BE) 2023/1114 (MiCA).

Ai synon të vendosë:

- Siguri juridike dhe mbrojtje të lartë për investitorët;
- Harmonizim me legjislacionin për investimet, pagesat dhe parane elektronike;
- Forcimin e kredibilitetit të vendit në raport me proceset e vlerësimit ndërkombëtar.

Ministria fton të gjitha palët e interesuara të japin komentet e tyre brenda afatit të konsultimit.

Projektligji gjendet në linkun:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/899>



## **IAIS publikon Raportin e Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025**

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, publikoi Raportin Vjetor të Tregut Global të Sigurimeve (GIMAR) për vitin 2025. Raporti jep informacione të marra nga Monitorimi Global i këtij viti, si edhe nga korniza e vlerësimit të rrezikut e IAIS, e projektuar për të monitoruar tendencat botërore të sektorit të sigurimeve dhe për të zbuluar rritjen e mundshme të rrezikut sistemik. GIMAR i vitit 2025 nxjerr në pah zhvillimet globale makrofinanciare dhe temat kryesore në të gjithë sektorin që ndikojnë në profilet e rrezikut të siguruesve, modelet e biznesit dhe prioritetet mbikëqyrëse.

Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të IAIS, Toshiyuki Miyoshi theksoi se “GIMAR 2025 nxjerr në pah qëndrueshmërinë e sektorit global të sigurimeve krahas ndryshimeve të rëndësishme strukturore. Ndërsa siguruesit përballen me zgjerimin e shpejtë të kredisë private, menaxhojnë rreziqet nga fragmentimi gjeoekonomik dhe përqafojnë rolin e Inteligjencës Artificiale, IA në zhvillim, mbikëqyrësit nga ana e tyre duhet të sigurojnë që qeverisja, menaxhimi i rrezikut dhe kornizat e monitorimit të forcohen për të adresuar këto ndryshime.”

Sekretari i Përgjithshëm i IAIS, Jonathan Dixon shtoi se: “Raporti i këtij viti riafirmon angazhimin e IAIS-it për të identifikuar rreziqet në zhvillim dhe për të mbështetur mbikëqyrësit kudo në adresimin e këtyre sfidave. Duke përmirësuar kornizat tona të monitorimit dhe mbikëqyrjes, ne synojmë të sigurojmë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të sektorit global të sigurimeve.”

*Vijon ...*

---

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025 gjendet në:

<https://www.iais.org/uploads/2025/12/Global-Insurance-Market-Report-2025.pdf>

---

## Global Insurance Market Report (GIMAR)

December 2025



### IAIS publikon Raportin e Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025

... Vijon

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve 2025 nxjerr në pah disa pika kryesore:

#### Aftësia paguese, rentabiliteti dhe likuiditeti

Aftësia paguese e sektorit mbetet e fortë në nivel global, duke u mbështetur nga rezerva të forta të kapitalit dhe menaxhim i disiplinuar i rrezikut. Pozicionet e likuiditetit mbeten të përshtatshme, me mbikëqyrësit që monitorojnë nga afër ekspozimet ndaj asetëve të cilat janë më pak likuide. Siguruesit raportuan një fitim të fortë në vitin 2024, të mbështetur nga disiplina e sigurimit dhe të ardhurat e qëndrueshme nga investimet. Siguruesit e Jo-Jetës në disa rajone kishin raporte të kombinuara të përmirësuar, ndërsa siguruesit e Jetës përfituan nga kushtet e favorshme të tregut. Pavarësisht pasigurive të vazhdueshme makroekonomike dhe gjeopolitike, perspektiva për sektorin e sigurimeve në vitin 2026 mbetet e qëndrueshme.

#### Rreziku sistemik

Të dhënat nga grupet e mëdha ndërkombëtare të sigurimeve tregojnë një rënie të lehtë në profilin e rrezikut sistemik të përgjithshëm, në nivelin global. Në një bazë ndërsektoriale, rezultatet e rrezikut sistemik për sektorin e sigurimeve mbeten dukshëm më të ulëta se ato të sektorit bankar, duke treguar një gjurmë relativisht më të ulët të rrezikut sistemik. Në vitin 2025, IAIS përfundoi shqyrtimin e rregullt trevjeçar të metodologjisë së vlerësimit të monitorimit të siguruesve individualë (IIM), duke forcuar më tej kornizën e tij për vlerësimin e rrezikut sistemik. Përveç kësaj, Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB) riafirmoi vendimin e tij për të përdorur Kornizën Holistike të IAIS për vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut sistemik në sektorin e sigurimeve si edhe për të informuar shqyrtimin e këtij rreziku.

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025 gjendet në

<https://www.iais.org/uploads/2025/12/Global-Insurance-Market-Report-2025.pdf>

## IAIS publikon Raportin e Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025

... Vijon

### **Kreditimi privat: fokus i shtuar mbikëqyrës**

Kapitulli i GIMAR, i dedikuar kredisë private thekson rëndësinë në rritje të saj në strategjinë e investimeve të siguruesve të Jetës. Megjithëse ekspozimet agregate mbeten të moderuara, raporti vëren rritjen e shpejtë të alokimeve të kredisë private në disa juridiksione. Kjo klasë e aseteve ofron avantazhe, por megjithatë ajo paraqet edhe rreziqe të dallueshme, duke përfshirë pasigurinë e vlerësimit, sfidat e likuiditetit, shqetësimet për cilësinë e kredisë së huamarrësit dhe kompleksitetin strukturor.

GIMAR i lidh këto gjetje me një tjetër dokument të publikuar nga IAIS mbi ndryshimet strukturore në sektorin e sigurimeve të Jetës, publikuar në nëntor. Të dy këto dokumente theksojnë nevojën për monitorim të forcuar, analizë më të thellë të rrezikut sistemik dhe zhvillimin e udhëzimeve mbikëqyrëse të ardhshme për të adresuar këto tendenca.

### **Fragmentimi gjeoekonomik: ndikimi në menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve nga siguruesit**

Raporti thekson se tensionet tregtare, sanksionet, politikat monetare divergjente dhe fragmentimi i tregut po kontribuojnë në paqëndrueshmërinë e tregut financiar, duke ndikuar në monedhat dhe normat e interesit, dhe duke çuar në pasiguri më të madhe në vlerësimet e aseteve dhe në menaxhimin më kompleks të aseteve e detyrimeve për grupet e sigurimeve që janë aktive në nivel ndërkombëtar. Mbikëqyrësit globalisht po reagojnë duke forcuar analizën e skenarëve, mbledhjen e të dhënave dhe duke nxitur koordinimin mbikëqyrës ndërkufitar.

### **Përshtatja dhe përdorimi i IA: mundësitë dhe rreziqet**

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale po zgjerohet në marrjen në sigurimin, çmimet dhe menaxhimin e dëmeve. Ndërsa siguruesit raportojnë përfitime të konsiderueshme operative, Raporti GIMAR 2025 thekson edhe shqetësimet mbikëqyrëse në lidhje me qeverisjen dhe transparencën e modelit, rreziqet kibernetike dhe operative, potencialin për paragjykim të të dhënave dhe rreziqet e përqendrimit nga palët e treta. Dokumenti i publikuar nga IAIS, në korrik 2025, mbi aplikimin dhe mbikëqyrjen e IA, ofron udhëzime të mëtejshme për mbikëqyrësit dhe siguruesit për adresimin e këtyre rreziqeve dhe sigurimin e përdorimit të përgjegjshëm të IA-së.

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025 gjendet në

<https://www.iais.org/uploads/2025/12/Global-Insurance-Market-Report-2025.pdf>

## IAIS publikon Raportin e Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025

... Vijon

### Rreziqet e lidhura me klimën

Ekspozimet e investimeve të siguruesve ndaj rreziqeve të lidhura me klimën kanë mbetur relativisht të qëndrueshme gjatë viteve të fundit. Raporti GIMAR 2025 nxjerr në pah modelet në zhvillim në mbulimin e rrezikut të katastrofave natyrore (NatCat) dhe nivelet e risigurimit me kalimin e kohës. Në përgjigje, si siguruesit ashtu edhe mbikëqyrësit po zbatojnë gjithnjë e më shumë analizën e skenarëve klimatikë, pavarësisht sfidave të të dhënave dhe metodologjisë. IAIS do të vazhdojë të përmirësojë vlerësimin e rrezikut klimatik.

### Tregu global i risigurimit

Risiguruesit ishin të mirëkapitalizuar në vitin 2024, me rezultatet e sigurimit që u stabilizuan pas humbjeve të larta nga katastrofat natyrore në vitet e mëparshme. Primet vazhduan të rriten, raportet e mbajtjes u rritën në mënyrë modeste dhe portofolet e investimeve mbetën të menaxhuara në mënyrë konservative.


Më tej, IAIS do të zgjerojë monitorimin e aseteve alternative duke përfshirë kredinë private, do të eksplorojë një analizë më të thellë të rrezikut sistemik, do të zhvillojë udhëzime mbikëqyrëse për ndryshimet strukturore në sigurimet e Jetës dhe do të vazhdojë të përsosë vlerësimet e rrezikut klimatik dhe boshllëqeve të mbrojtjes NatCat.

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve për vitin 2025 gjendet në

<https://www.iais.org/uploads/2025/12/Global-Insurance-Market-Report-2025.pdf>

## Mbi mbikëqyrjen efektive të pensioneve – Material për Diskutim i IOPS

IOPS Working Papers on Effective Pensions Supervision, No.45



Materiali për diskutim gjendet në:

<https://www.iopsweb.org/content/dam/iops/en/working-papers/WP45-Survey-report-on-infrastructure-investments.pdf>

Materiali për Diskutim paraqet gjetjet nga anketa e IOPS 2024 mbi investimet në infrastrukturë dhe faktorët ESG në fondet e pensioneve, bazuar në përgjigjet nga 32 autoritete mbikëqyrëse. Analiza identifikon sfida të vazhdueshme në mbledhjen e të dhënave, vlerësimin e aseteve dhe integrimin e faktorëve ESG, së bashku me praktikat më të mira dhe rekomandimet e politikave. Çështjet kryesore përfshijnë mungesën e të dhënave të detajuara dhe të krahasueshme, metodologjitë e vlerësimit të fragmentuara dhe mungesën e taksonomive të harmonizuara për faktorët ESG.

Mbikëqyrësit raportojnë kufizime të kapaciteteve dhe boshllëqe në qeverisje që pengojnë mbikëqyrjen efektive. Raporti rekomandon krijimin e kornizave të standardizuara të të dhënave, promovimin e vlerësimeve të pavarura dhe integrimin e faktorëve ESG në proceset e investimit. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të forcojnë qeverisjen, të miratojnë platforma dixhitale të raportimit dhe të inkurajojnë diversifikimin gjeografik për të zbutur rreziqet politike dhe të reputacionit. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve janë thelbësore për të harmonizuar praktikat dhe për të rritur rezistencën ndaj goditjeve të lidhura me klimën.

Vijon ...

## Mbi mbikëqyrjen efektive të pensioneve – Material për Diskutim i IOPS

... Vijon

Autoritetet mbikëqyrëse duhet të forcojnë qeverisjen, të miratojnë platforma dixhitale të raportimit dhe të inkurajojnë diversifikimin gjeografik për të zbutur rreziqet politike dhe të reputacionit. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve janë thelbësore për të harmonizuar praktikat dhe për të rritur rezistencën ndaj goditjeve të lidhura me klimën.

*Shënim:*

*Përqindja e të ardhurave të pensionit, të ofruara nga pensionet private, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Por po kështu, krahas saj po bëhet gjithnjë e më thelbësor, edhe cilësia dhe efektiviteti i mbikëqyrjes së tyre. Seria e Materialeve për Diskutim të IOPS, e lançuar që në gusht 2007, nxjerr në pah një sërë sfidash që duhen përballuar në zhvillimin e sistemeve kombëtare të mbikëqyrjes së pensioneve. Materialet shqyrtojnë natyrën dhe efektivitetin e sistemeve të reja të mbikëqyrjes së pensioneve, duke ofruar shembuj, përvoja dhe mësimet të nxjerra në dobi të anëtarëve të IOPS dhe komunitetit më të gjerë të pensioneve.*

*Materialet për Diskutim të IOPS nuk janë botime formale. Ato paraqesin rezultate dhe analiza paraprake dhe qarkullojnë për të inkurajuar diskutimin dhe komentet.*



Materiali për diskutim  
gjendet në:

[https://www.iopsweb.org/  
/content/dam/iops/en/w  
orking-papers/WP45-  
Survey-report-on-  
infrastructure-  
investments.pdf](https://www.iopsweb.org/content/dam/iops/en/working-papers/WP45-Survey-report-on-infrastructure-investments.pdf)





Për informacion  
të mëtejshëm  
kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [ëëë.amf.gov.al](http://ëëë.amf.gov.al)